



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Prishtinë, më 28 korrik 2022

Vendimi nr. 28/22

Duke u bazuar në nenet 15,17,18,19,20 dhe 28 të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, nenin 8 të Ligjit nr. 04/L-226 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 28.07.2022, mori këtë:

#### V E N D I M

- I. LEJOHET** Përqendrimi i kompanive Telekom Slovenije d.d, (blerës) dhe DBA informaciske tehnologije, d.o.o, DBA Group S.P.A, (shitësit), mbi Actual I.T. Telekom Slovenije, d.d, është kompani e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Sllovenisë, me seli në Cigaletova ulica 15, 1000 Lublanë, Slloveni, me nr. të biznesit 5014018000. Telekom Slovenije d.d ka degë në Republikën e Kosovës, e cila ka nën pronësi IPKO Telecommunications L.L.C dhe SIOL L.L.C.
- Ndërmarrja DBA informaciske tehnologije, d.o.o është kompani aksionare, me seli në Ferrarska ulica 14, 6000 Koper, Slloveni. DBA Group S.P.A. është kompani e pavarur holding, me seli në Viale Felissent, 20\D, Slloveni.
  - Actual I.T, informaciske tehnologije d.d është e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Sllovenisë, me seli në Ferrarska ulica 14, 6000 Koper, Capodistria, Slloveni dhe me nr. të regjistrimit të biznesit 5858534000.
- II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 100.00 € (*njëqind euro*) dhe për Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në vlerë prej 3,000.00 € (*tremijë euro*).

#### Arsyetim

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me datë 17.06.2022 ka pranuar kërkesën me nr. prot.172/22-01/H, lidhur me njoftimin për realizimin e përqendrimit përmes parashtruesit të kërkesës znj. Vjollca Hiseni, përfaqësuese ligjore e Kalo & Associates, adresa rr. Mujo

Ulqinaku 5/1, Prishtinë, për ndërmarrjet: Telekom Slovenije d.d, (blerës) dhe DBA, informaciske tehnologije, d.o.o, DBA Group S.P.A, (shitësit), të realizuar përmes blerjes së aksioneve mbi Actual I.T më të cilën Telekom Slovenije do të blejë 100% të kapitalit aksionar në Actual I.T, nga DBA, informaciske tehnologije, d.o.o.

Kërkesa për përqendrim në Kosovë është bërë, për arsye se Telekom Slovenije d.d ka degë në Republikën e Kosovës, pra ka në pronësi IPKO Telecommunications L.L.C dhe SIOL L.L.C.

IPKO Telecommunications L.L.C, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, e regjistruar me numër të biznesit 810485301, me seli në Rr. Zija Shemsiu Nr. 34, Prishtinë.

Ndërmarrja SIOL Prishtina L.L.C, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me numër të regjistrimit të biznesit 811360221, me seli në Rr. Mujo Ulqinaku, 5/1, Prishtinë. Aktiviteti i regjistruar i SIOL L.L.C është aktiviteti i telekomunikacionit kabllor.

Aktivitetet e biznesit: është operator i telekomunikacionit, ofrues i shërbimeve dhe shitës i produkteve në fushën e teknologjive i regjistruar si SIOL L.L.C, ku aktiviteti kryesor e ka në telekomunikacionin kabllor.

#### **Procedurat e ndjekura:**

- a) Vlerësimi i lëndës/dokumentacionit
- b) Njoftimi për realizimin e përqendrimit në ueb faqen e AKK-së, me datë 28.06.2022.
- c) Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 29.06.2022
- ç) Dokumentacioni i nevojshëm për qëllimin e njoftimit të Përqendrimit.

Kërkesa për Përqendrim është e bazuar në Marrëveshjen për Blerje të Aksioneve, të lidhur me datë 28 Mars 2022 më të cilën Telekom Slovenije do të blejë 100% të kapitalit aksionar në Actual I.T, nga DBA, informaciske tehnologije, d.o.o. Andaj, në bazë të kërkesës Sekretariati i Autoritetit ka bërë vlerësimin e Kërkesës për Përqendrim.

#### **Baza juridike:**

Sipas nenit 15 të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-226 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- Qarkullimi i kombinuar i palëve në mbarë botën, kalon shumë më 20 milion euro.
- Kompania Telekom Slovenije d.d, ka për qëllim blerjen e 100% të aksioneve të Actual I.T.

#### **Vlerësimi i Konkurrencës**

##### ***Tregu Relevant i produktit***

Tregu i produktit – Telekom Slovenije është operator i telekomunikacionit, ofrues i shërbimeve dhe shitës i produkteve në fushën e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimeve.

### ***Tregu Gjeografik***

Vlerësimi i transaksionit, palët në përqendrim parashtrajnë se të gjitha tregjet potencialisht të afektuara nga transaksioni, janë nacionale në natyrën e tyre nga këndvështrimi gjeografik, të paktën të përfshijnë edhe territorin e Zonës Ekonomike Evropiane dhe të vendeve që janë anëtare të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), sepse për sektorin e ofrimit të shërbimeve të IT-së, nuk ka kufizim të tregjeve. Meqenëse aktivitetet e Telekom Slovenije d.d. do të kufizohen kryesisht, në territorin e Republikës së Sllovenisë, transaksioni nuk do të ketë efekte për konkurrencën në tregun e saj.

### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar**

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni si në Marrëveshje që do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Sllovenisë. Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se pala blerëse është prezent përmes dy kompanive që gjenerojnë shitje në tregun e Kosovës **IPKO Telecommunications L.L.C. dhe SIOL L.L.C.** Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara vërejmë se targeti nuk është prezent në tregun e Republikës së Kosovës qoftë përmes personit juridik ose nëpërmjet shitjeve dhe si i tillë nuk do të ketë mbivendosje horizontale apo vertikale të tregut. Në Kosovë transaksioni nuk do të qojë në kufizim, shtrembërim ose parandalim të konkurrencës në tregun përkatës në veçanti jo duke krijuar ose forcuar një pozitë të re dominuese.

Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar që transaksioni nuk paraqet efekte negative në konkurrencë për arsye se ky transaksion/bletje nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët andaj, duke u bazuar në Ligjin 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës ka përdorur procedurën e shkurtë.

### **Shënim:**


Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

IV. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare



**KOMISIONI**  
Neime Binaku-Isufi  
Kryetare



Nafije Osdatuaj  
Anëtare

